



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**    **Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2020

**Nr. Dok.**

**Lënda:**                      *Rekomandohet zbatimi i legjislacionit lidhur me njoftimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe kohën e ekzekutimit të këtij vendimi si dhe marrja e masave disiplinore për punonjësit që nuk kanë zbatuar ligjin për rastin e ndërhyrjes në zonën e "Bregut të Lumit".*

**BASHKISË TIRANË**

Kryetarit  
Z. Erion Veliaj

**BASHKISË TIRANË**

Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit  
Kryeinspektorit  
Z. Mariglen Qato

*Të nderuar,*

Sikurse jeni vënë në dijeni nga letërkëmbimi i mëparshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një hetim administrativ lidhur me ankesat e banorëve që kanë protestuar dhe kundërshtuar prishjen e banesave të tyre në datat 8 dhe 9 Prill 2019, në zonën e "Bregut të Lumit", gjatë zbatimit të projektit urbanistik "Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës". Sipas banorëve, të cilët janë shprehur para kamerave të mediave që kanë qenë të pranishme në vendngjarje por edhe para përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit, punonjës të policisë kanë ndërhyrë herët në mëngjes, në datën 9 Prill, kur ata kanë qenë në gjumë si dhe kanë hedhur gaz lotsjellës në mjedise të mbyllura, ndërkohë që brenda banesave ka patur persona, ndër ta edhe fëmijë. Pas kësaj ndërhyrje banesat janë shembur.

Të vënë në dijeni nga raportimet e mediave lidhur me situatën e rëndë të krijuar në këtë zonë në datat 8 dhe 9 Prill 2019, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, kanë shkuar në vendngjarje për të monitoruar nga afër gjendjen, kanë marrë kontakt me banorët si dhe më pas kanë kryer veprime hetimore për të verifikuar pretendimet e ngritura. Duam të vëmë në dukje faktin që në datën 8 Prill 2019, përfaqësuesit e institucionit janë penguar të kryejnë detyrën e tyre nga punonjës të Policisë Bashkiake, pasi u është refuzuar monitorimi nga afër i veprimeve të IMT-së dhe Policisë së Shtetit.

Me marrjen në shqyrtim të ankesave të banorëve, i jemi drejtuar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, me tre shkresa<sup>1</sup>, përsa i përket procedurës së ndjekur nga ana e këtij organi për njoftimin e banorëve me vendimin për prishjen e banesave si dhe orarit të nisjes së operacionit për zbatimin e këtij vendimi. Kemi qenë të detyruar për të nisur tre shkresa, jo vetëm për të kërkuar dokumentacion shtesë që provonte njoftimin faktik të banorëve, por edhe për të marrë një përgjigje shteruese lidhur me orarin e nisjes së operacionit, informacion që nuk na është dhënë i plotë që në përgjigjen e parë. Kjo ka bërë që hetimi administrativ të shtyhet në kohë.

Më konkretisht, me shkresat tona të përmendura më lart kemi kërkuar shpjegime se cila ishte mënyra e përdorur e njoftimit, nëse njoftimet u janë dërguar banorëve me anë të postës apo në një rrugë tjetër ligjore, orarin faktik kur ka filluar operacioni i datës 9 Prill 2019 dhe arsyen pse ekzekutimi i vendimit për prishjen e banesave nuk është kryer sipas orarit të përcaktuar në dokumentet zyrtare. Përpos informacionit, kemi kërkuar të na dërgohet edhe një kopje e dokumenteve zyrtare, që vërtetojnë dërgimin e njoftimit me postë, apo në rast njoftimi me mënyra të tjera ligjore, dërgimin e dokumentacionit respektiv, që vërteton ezaurimin e kësaj procedure njoftimi të ndjekur. Gjithashtu kemi administruar informacion dhe dokumentacion nga disa institucione të tjera, që na kanë shërbyer në kuadër të një hetimi më të plotë administrativ, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv. Informacioni dhe dokumentacioni u është kërkuar përkatësisht Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Komisarariatit të Policisë Nr.4, Tiranë dhe Spitalit Universitar të Traumës Tiranë.

Në përgjigjet<sup>2</sup> e kthyera prej IMT të Bashkisë Tiranë jemi informuar si më poshtë:

*“IMT Bashkia Tiranë ka mbajtur procedurë ligjore për prishjen e objekteve që preken nga projekti “Bulevardi Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës”, mbështetur në Ligjin Nr.183, datë 24.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, VKM Nr.894, datë 04.11.2015 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore” dhe Ligji Nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.*

*Për sa më sipër, Bashkia Tiranë në zbatim të projektit të cituar më lart, duke hasur në rezistencën e vazhdueshme të banorëve, ka kërkuar mbështetjen e institucioneve të tjera shtetërore nëpërmjet shkresës Nr.14751 prot., datë 04.04.2019.*

<sup>1</sup> Shkresat me Nr.K2/F16-13 Prot., datë 29.05.2019, Nr.K2/F16-19 Prot., datë 26.06.2019 dhe Nr.K2/F16-25 Prot., datë 17.01.2020.

<sup>2</sup> Shkresat me Nr.23065/1 Prot., datë 13.06.2019, Nr.23065/3 Prot., datë 13.09.2019 dhe Nr.27778/1 Prot., datë 21.02.2020.

*Për ndërhyrjen në datën 8-9 Prill 2019, nga ana e IMT Tiranë janë njoftuar në mënyrë të vazhdueshme subjektet që posedonin objektet që prekeshin nga zbatimi i këtij projekti. Duke qenë se situata në terren ka qenë vazhdimisht problematike dhe nga ana e banorëve është bërë rezistencë në marrjen e këtyre njoftimeve, për ndërhyrjen në datat 8-9 Prill 2019 njoftimi është bërë në mënyrë verbale. Ndërhyrja u krye në datën 9 Prill 2019, në orën 08:00 dhe po në këtë orar ka filluar ekzekutimi i vendimeve të prishjes.*

*IMT, Bashkia Tiranë në zbatim të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (i ndryshuar), VKM Nr.894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”, Ligji Nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ka njoftuar disa herë banorët për ndërhyrje në datat: 24-28 Dhjetor 2018, ora 10:00; 26-27 Shkurt 2019 ora, 10:00; 5-6 Mars 2019 ora, 10:00.*

*Për shkak të situatës së rënduar në terren, njoftimet për ndërhyrje nga ana jonë IMT Bashkia Tiranë janë bërë në mënyrë formale, nëpërmjet dorëzimit personalisht, sipas neneve 157, 158 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.*

Referuar dokumentacionit që na është dërguar me shkresën Nr.23065/1 Prot., datë 13.06.2019 rezulton se:

- Në muajin Dhjetor 2018 janë protokolluar 7 shkresa të IMT Bashkia Tiranë ku 7 shtetas njoftohen në adresën rruga “Siri Kodra”, Tiranë për vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, vendim që do të ekzekutohej në datat 24-28 Dhjetor 2018, ora 10:00;
- Në muajin Shkurt 2019 janë protokolluar 7 shkresa ku 7 shtetas njoftohen për vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, vendim që do të ekzekutohej në datat 26-27 Shkurt 2019, ora 10:00;
- Në muajin Mars 2019 janë protokolluar 7 shkresa ku 7 shtetas njoftohen për vendimin e prishjes së objektit të kundërligjshëm, vendim që do të ekzekutohej në datat 5-6 Mars 2019, ora 10:00.
- Me shkresën Nr.492 Prot., datë 07.01.2019, IMT Bashkia Tiranë i është drejtuar Njesisë Administrative Nr.8 me kërkesën për njoftimin me anë të shpalljes të vendimit të datës 05.12.2018 (gjobë dhe prishje e objektit të kundërligjshëm) për banorët që disponojnë objekte që preken nga zbatimi i projektit “*Bulevardi Verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës*”;
- Njësia Administrative Nr.8. me shkresën Nr.77/1 Prot., datë 11.01.2019, ka vënë në dijeni IMT Bashkia Tiranë se janë afishuar vendimet në këndin e posaçëm të njësisë.
- IMT Bashkia Tiranë, me shkresën Nr.14751 Prot., datë 04.04.2019, i është drejtuar disa institucioneve për të mbështetur operacionin e prishjes së disa ndërtesave në Bulevardin e Ri Verior, në datat 8-9 Prill 2019, ora 10:00.

Nuk na është komunikuar nga ana juaj një listë tërësore për të evidentuar të tëra rastet e për çdo banor ndërtesa e të cilit do të prekej nga projekti. Për të analizuar nëse veprimet e IMT Bashkia Tiranë në lidhje me njoftimin e banorëve me vendimin për prishjen e banesave, janë kryer sipas procedurës së parashikuar në ligj, i referohemi akteve normative që rregullojnë këtë veprimtari.

Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar përcakton se:

- “Kontrolli i Territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga:  
a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse” (neni 3/a).
- Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:  
d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm,” (neni 5/d).

Ndërsa në pikën 4, të VKM Nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore” parashikohet se:

“ Kryeinspektori/inspektori i inspektoratit të njësisë vendore, pas kontrollit në objekt apo në vendin ku kryhen punimet, mban procesverbalin, ku pasqyrohen gjendja aktuale, mangësitë dhe detyrat për subjektin ndërtues, dhe, për shkeljet e vëna re, zbaton procedurat ligjore në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar.

Procesverbali përkatës i konstatimit nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu dhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë. Një kopje e procesverbalit i jepet subjektit të kontrolluar.

Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në procesverbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e procesverbalit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e kontrollit.

Nëse identiteti dhe adresa e subjektit të kontrolluar nuk dihen, një kopje e procesverbalit të konstatimit afishohet për 5 (pesë) ditë në vendpublikimet e njësisë vendore përkatëse dhe në kantierin e ndërtimit. Me kalimin e këtij afati, vlerësohet se subjekti i kontrolluar është njoftuar për rezultatin e kontrollit.

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori”.

Procedura e komunikimit të veprimeve administrative nga organi publik si dhe koha e ekzekutimit të detyrueshëm të aktit administrativ rregullohen nga Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>3</sup>. Konkretisht njoftimi, rregullat e përgjithshme të njoftimit, personi përgjegjës për njoftimin si dhe mënyrat dhe mjetet e njoftimit rregullohen në Pjesën e Shtatë, nga dispozitat e neneve 147 e në vijim të KPRA-së, si më poshtë:

Neni 147

Njoftimi i përshtatshëm

---

<sup>3</sup> Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

*“1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.*

*2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ.*

*3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston”.*

Neni 148

Format e njoftimit

*“1. Njoftimi, kur pala është e pranishme, mund të bëhet verbalisht, apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit.*

*2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.*

Neni 151/1

Vendi i njoftimit

*“1. Njoftimi bëhet në:*

*a) vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;*

*b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;*

*c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;*

*ç) vendin e punës;*

*d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;*

*dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala”.*

Neni 155

Njoftimi nëpërmjet postës

*“1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur.*

*2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.*

*3. Pika 2, e këtij neni, nuk zbatohet nëse marrësi provon se dokumenti nuk është marrë, apo është marrë në një ditë të mëvonshme”.*

Neni 157

Njoftimi formal

*“Njoftimi i një shkrese mund të bëhet edhe nëpërmjet njoftimit formal, në rastet kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji, apo kur vendoset nga vetë organi publik”.*

## Neni 158

### Mënyrat e njoftimit formal

*“Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi”.*

## Neni 159

### Dorëzimi personalisht

*“1. Nëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod. Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga nëpunësi dhe marrësi.*

*2. Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë.*

*3. Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit, duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit, dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.*

*4. Dorëzimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e vendosjes së shënimit.*

*5. Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 07:00 deri në 19:00”.*

## Neni 162

### Njoftimi publik

*“1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:*

*a) kur palët janë të panjohura;*

*b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;*

*c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;*

*ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.*

*2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.*

*3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.*

4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh.

5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrative”.

Neni 171

Koha e ekzekutimit të detyrueshëm

“Ekzekutimi i detyrueshëm në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, si dhe ekzekutimi ndërmjet orës 19:00-07:00 mund të kryhet vetëm në rast urgjence nëse, si pasojë e mosekzekutimit, cenohet interesi publik, bazuar në një urdhër me shkrim të arsyetuar të organit kompetent për ekzekutimin”.

Për të vlerësuar pretendimet e banorëve në ankesat e tyre, kemi analizuar momentin e njoftimit të aktit administrativ të prishjes së banesave, si një pjesë shumë e rëndësishme e procedurës ligjore që duhet ndjekur nga ana e organit të administratës publike, për mundësimin e fillimit të efekteve dhe pasojave juridike të aktit administrativ të nxjerrë nga ky organ.

Më konkretisht, në pikën 1, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, thuhet se: “Një akt administrativ fillon të sjellë pasojë juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve”.

Nga shpjegimet e dhëna dhe kopja e dokumentacionit të dërguar nga ana e IMT Bashkia Tiranë, rezulton se nuk është vepruar në përputhje me parashikimet ligjore, pasi nuk është arritur të vërtetohet me anë të akteve zyrtare përkatëse se është vepruar sipas ligjit, lidhur me njoftimin e vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm dhe orarin e ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu, megjithëse kemi përsëritur disa herë kërkesat, nuk kemi marrë dokumentacion të plotë për të tëra praktikat e zbatuara në atë ditë.

IMT Bashkia Tiranë nuk na ka vënë në dispozicion dokument zyrtar që të provojë se janë nisur dhe dorëzuar me postë një pjesë vendimet për prishjen e banesave në muajin Dhjetor 2018 dhe Mars – Shkurt 2019. Na janë vënë në dispozicion vetëm vendimet e protokolluara, me emrin e banorit përkatës dhe adresën e tij, por këto nuk janë tregues që provojnë se vendimi u është njoftuar banorëve. Në datën 07.01.2019, IMT Bashkia Tiranë i është drejtuar Njesisë Administrative Nr.8 me kërkesën për njoftimin me anë të shpalljes të vendimit të datës 05.12.2018 (gjobë dhe prishje e objektit të kundërligjshëm), por nuk kemi marrë ndonjë shpjegim pse është vendosur komunikimi i vendimit me *njoftim publik*, nëse IMT është ndodhur para rasteve të parashikuara në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe në pikën 4 të VKM Nr.894, datë 04.11.2015. Ndërsa, për sa i përket njoftimit për prishjen e banesave në datën 8-9 Prill 2019, nuk na është vënë në dispozicion ndonjë dokument që të provojë se vendimi u është njoftuar banorëve personalisht, sikurse pretendohet nga IMT, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 159, të Kodit të Procedurave Administrative. Vlerësojmë së

respektimi i procedurës të përcaktuar në ligj është një garanci minimale dhe e vetmja mënyrë për të mbrojtur qytetarin nga abuzivizmi dhe ajo nuk duhet të përdoret si mjet për të shmangur plotësimin e detyrimeve.

Gjithashtu provohet se, vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm është ekzekutuar në një orë që vjen në kundërshtim me nenin 171 të Kodit të Procedurave Administrative dhe vetë planifikimin e bërë nga IMT Bashkia Tiranë. Ky organ, me shkresën Nr.14751 Prot., datë 04.04.2019, i është drejtuar disa institucioneve për të mbështetur operacionin e prishjes së disa ndërtesave në Bulevardin e Ri Verior, në datat 8-9 Prill 2019, ora 10:00. Sipas përgjigjes së marrë nga IMT, ndërhyrja në datën 9 Prill 2019 është kryer në orën 08:00 dhe po në këtë orar ka filluar ekzekutimi i vendimeve të prishjes. Por, faktikisht nga analiza e provave të ndryshme të administruara nga ana jonë ndërhyrja ka filluar më herët se ora 08:00. Nga hetimi në tërësi i situatës së krijuar në këtë datë, rezulton se një nga banoret e zonës, shtetasja F.M. që ka kundërshtuar prishjen e banesës, është shoqëruar fillimisht në Komisaratin e Policisë Nr.4 dhe më pas është dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin Universitar të Traumës, ku është paraqitur në orën 08:02 (sipas konfirmimit mbi bazën e komunikimit shkresor me Spitalin Universitar të Traumës dhe Komisaratin e Policisë Nr.4 Tiranë). Ky është një tregues që faktori se ndërhyrja ka filluar më herët se ora 08:00 dhe IMT Bashkia Tiranë nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se pse ekzekutimi i vendimit nuk ka filluar në orën 10:00, sipas parashikimit në shkresën drejtuar disa institucioneve për mbështetje.

Në vijim të analizës sonë, sjellim në vëmendjen Tuaj, parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 4, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit:

*“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.*

*2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.*

Në këtë rast është shkelur një e drejtë themelore, që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është afirmuar si, e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Fryma dhe logjika e Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”* dhe VKM Nr. 894, datë 04.11.2015 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore”*, në përcaktimin e kompetencave dhe afateve procedurale, për konstatimin e ndërtimit të kundërligjshëm, nxjerrjen e vendimit përkatës penalizues për kundërvajtësin, njoftimin e këtij vendimi dhe ekzekutimin e tij, është e tillë që shkon në të njëjtën linjë përputhshmërie me respektimin e së drejtës themelore të individit, për një proces të rregullt ligjor.

Në përfundim të hetimit, sjellim në vëmendje detyrimin ligjor që kanë nëpunësit e administratës publike për të bashkëpunuar me Institucionin e Avokatit të Popullit, si në kryerjen e verifikimeve



apo veprimeve në vend, ashtu dhe në marrjen e çdo shpjegimi, dosje apo materiali që ka lidhje me hetimin. Mungesa e bashkëpunimit çënon jo vetëm imazhin dhe besimin publik të organit, por njëkohësisht ai pengon kryerjen e misionit kushtetues të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese e ligjore të shtetasve nga organet e administratës publike.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

### **REKOMANDOJMË:**

- Analizimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit që nuk kanë zbatuar legjislacionin lidhur me procedurën e komunikimit të veprimeve administrative nga organi publik (në rastin konkret për prishjen e objektit të kundërligjshëm) si dhe kohës së ekzekutimit të aktit administrativ.
- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat, përgjigjet kanë rezultuar të paplota dhe me përmbajtje të pasaktë në disa aspekte.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse me qëllim mospërsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda një afati kohor të përshtatshëm.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**

Përgatiti: Adil Skuqi, Ndhmëskomisioner